



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18857 Prot.

Lezhë, më 01 . 11 . 2021

VENDIM

Nr. 153 Datë 28 . 10 . 2021

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “ PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE  
RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË SHORTIT PËR PËRFITIMIN E BANESAVE NË  
PALLATET E RINDËRTUARA PËR SHKAK TË TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019””**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2 , nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” , nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d " , nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “ Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 "Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të zhvillimit të shortit për përfitimin e banesave në pallatet e rindërtuara për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA LEZHË

# RREGULLORE

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE  
RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË SHORTIT  
PËR PËRFITIMIN E BANESAVE NË PALLATET E  
RINDËRTUARA PËR SHKAK TË TERMETIT TË  
DATËS 26.11.2019**

**LEZHË 2021**

1



## **Neni 1**

### **Baza Ligjore**

Rregullorja “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të zhvillimit të shortit për përfitimin e banesave në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019”, bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Aktin normativ nr. 09, date 16.12.2019 "Per përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën dhe rregullat e zhvillimit të shortit për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës së hollësishme për mënyrën e zhvillimit të shortit për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, rregullave dhe pasojave juridike të procesit të shorteut.

## **Neni 3**

### **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton:

- a) Rregulla të hollësishme për mënyrën e zhvillimit të shortit për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019;
- b) Procedurat administrative që do të ndiqen nga Bashkia Lezhë për mënyrën e zhvillimit të shortit, njoftimet për pjesëmarrësit në short dhe rënditjen e përfituesve sipas sistemit të pikëzimit për të drejtën e përzgjedhjes me përparësi në short;

## **Neni 4**

### **Përkufizime**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:





1. “Short”, është procesi rastësor i përzgjedhjes manuale të apartamenteve nga ana e përfituesve të shpallur me Vendim të Këshillit Bashkiak në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019.
2. “Komisioni i Organizimit të Shortit”, është komisioni i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, i cili ka përgjegjësi për organizimin e shortit për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019.
  3. “Sekretariati i Komisionit”, është struktura e posaçme që ka detyra teknike në mbështetjen e Komisionit e Organizimit të Shortit nga ana administrative.
  4. “Subjekte përfitues”, janë subjektet të cilët përfitojnë strukturë banimi në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, sipas strukture së banimit të përcaktuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.
  5. “Pikëzimi”, është vlerësimi i bërë nga bashkia sipas sistemit të pikëzimit me pikë të përcaktuar nga Këshillit Bashkiak në momentin e shpalljes së subjekteve si përfitues.
  6. “Kategoritë prioritare”, janë subjektet që trajtohen si kategori prioritare të përcaktuara në pikën 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar.
  7. “Lista e përzgjedhjes”, është lista e përgatitur nga bashkia në të cilën janë renditur subjektet përfitues në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, në bazë të strukturës së banimit që përfitojnë dhe pikëve të marra sipas sistemit të pikëzimit.
  8. “E drejta e përzgjedhjes”, është e drejta e subjekteve përfitues të renditur të parët në listë për të përzgjedhur të parët në short.
  9. “Njoftimi i përgjithshëm për shorteun publik”, është njoftimi i cili do të bëhet nga bashkia për thirrjen e pjesmarrësve në short. Njoftimi të realizohet nëpërmjet mediave audiovizive lokale, rrjeteve sociale të bashkisë, faqes zyrtare të saj, me shpallje në të gjitha njësitet administrative dhe në pallatet e rindërtuara.
  10. “Njoftim individual për pjesmarrje në short”, është njoftimi nga bashkia i çdo përfituesi në mënyrë individuale për pjesmarrje në shorteun publik.
  11. “Procesverbal individual”, është procesverbali i mbajtur nga sekretariati i komisionit sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr.1 bashkëlidhur kësaj rregullore, për rezultatet e përzgjedhjes së kryer nga subjekti përfitues individualisht.
  12. “Procesverbal përmbledhës”, është procesverbali i mbajtur nga sekretariati i komisionit sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr.2 bashkëlidhur kësaj rregullore për rezultatet përmbledhëse për të gjitha subjektet përfituese pjesmarrës dhe në mungesë në këtë proces.

## Neni 5

### Transparenca

1. Organizimi i shorteut publik do të bëhet në mënyrë transparente, i lehtë për t’u aksesuar nga të gjithë, i kuptueshëm dhe publik.
2. Zhvillimi i shorteut publik do të bëhet në prani të:

- 
- a) Një përfaqësuesi nga Prefektura e Qarkut Lezhë;
  - b) Një përfaqësuesi nga Këshilli i Bashkisë Lezhë;
  - c) Një përfaqësuesi nga Ministria Përgjegjëse për Rindërtimin.

## Neni 6

### Njoftimi për zhvillimin e shorteut publik

1. Njoftimi i përgjithshëm për shorteun publik do të bëhet 15 (pesëmbëdhjetë ditë) përpara datës së hedhjes së shorteut nëpërmjet lajmërimeve publike, të cilat afishohen në ambientet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në mediat audiovizive lokale, rrjeteve sociale të bashkisë, faqes zyrtare të saj, me shpallje në të gjitha njësitë administrative dhe në pallatet e rindërtuara. Njoftimi duhet të përmbajë listën e përfituesve dhe vendndodhjen/zonën e objektit.
2. Krahas njoftimit të përgjithshëm për hedhjen e shortit, bëhet edhe thirrja, nëpërmjet njoftimit të çdo përfituesi, pjesë e shortit publik për pjesëmarrje në këtë shorte, e cila duhet të përmbajë:
  - a) njësinë e vetëqeverisjes vendore që e ka nxjerrë;
  - b) emrin, mbiemrin e personit të thirrur, përfitues nga programi i rindërtimit;
  - c) përbërjen familjare dhe strukturën e banesës takuese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
  - d) vendndodhjen/zonën ku është/janë ndërtuar objekti/objektet ose zona sipas marrëveshjes paraprake për kalimin e së drejtës së pronësisë;
  - e) vendin dhe datën e organizimit të shorteut publik;
  - f) si dhe pasojat në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në shorte.
3. Njoftimi i përgjithshëm publik dhe njoftimi individual i të gjithë përfituesve do të bëhen nga bashkia sipas afateve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni.
3. Për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shorteut publik duhet të njoftohen për të marrë pjesë:
  - d) Prefektura e Qarkut Lezhë;
  - e) Këshilli i Bashkisë Lezhë;
  - f) Ministria Përgjegjëse për Rindërtimin.

## Neni 7

### Lista e përzgjedhjes

1. Bashkia përgatit listën e përzgjedhjes në të cilën renditen subjektët përfitues në pallatet e rindërtuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, në bazë të strukturës së banimit që përfitojnë dhe pikëve të marra sipas sistemit të pikëzimit.
2. Rënditja në listën e përzgjedhjes bëhet në bazë të pikëzimit të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak ku subjektet janë shpallur përfitues dhe struktura e banimit që këto subjekte përfitojnë sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë.
3. Në rastet kur subjektet kanë pikë të njëjta, rënditja për këto subjekte do të bëhet në bazë të rendit alfabetik.



4. Kategoritë prioritare kanë të drejtën e përzgjedhjes në shorte me përparësi ndaj atyre jo prioritar dhe do të përzgjedhin në shorte sipas renditjes në listen e përzgjedhjes.

### **Neni 8**

#### **Përbërja dhe detyrat e Komisionit të Organizimit të Shortit**

1. Komisioni i Organizimit të Shortit përbëhet nga tre anëtar që zgjidhen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
2. Komisioni i Organizimit të Shortit ka këto detyra:
  - a) merr masa për organizimin e shortit në mënyre transparente;
  - b) therret me rradhë sipas listës së përzgjedhjes përfituesit për të përzgjedhur në short;
  - c) shpall rezultatin e përzgjedhjes së përfituesit;
  - d) kujdeset që rezultati i përzgjedhjes së përfituesit të regjistrohet në mënyrë të saktë nga Sekretariati i Komisionit;
  - e) fton përfituesin përzgjedhës për të firmosur procesverbalin e përgatitur nga Sekretariati i Komisionit;
  - f) firmos të gjitha procesverbalet e rezultatit të përzgjedhjes në mënyre individuale dhe procesverbalin përmbledhës;

### **Neni 9**

#### **Sekretariati i Komisionit**

1. Sekretariati i Komisionit merr masa për evidentimin dhe dokumentimin e të gjithë procesit të shorteut publik.
2. Merr masa që anëtarët e Komisionit të kenë një kopje të plotë të dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e shorteut publik, konkretisht:
  - a) listën e përzgjedhjes;
  - b) Vendimin e Këshillit Bashkiak me të cilin është përcaktuar struktura e banimit që subjektet që përfitojnë;
  - c) dokumentat e identifikimit të përfituesve ose përfaqësuesve të tyre me prokurë që do bëjnë përzgjedhjen në short.
3. Mban procesverbale individuale të rezultatit të përzgjedhjes nga ana e përfituesit.
4. Mban procesverbalin përmbledhës të rezultatit të shorteut publik.

### **Neni 10**

#### **Zhvillimi i shorteut**

1. Në ditën, vendin dhe orën e njoftuar për zhvillimin e shorteut publik Komisioni së bashku me sekretariatën marrin masa për thirrjen e përfituesve për t'u vendosur në ambientet e përcaktuara për zhvillimin e shorteut.
2. Pas akomodimit të subjekteve pjesëmarrëse në shorte, kryetari i Komisionit, shpjegon procedurën se si do të kryhet përzgjedhja dhe sipas listës së përzgjedhjes thërret me rradhë subjektet për të kryer përzgjedhjen sipas struktës së banimit për të cilën janë shpallur përfitues.

3. Subjekti i cili do të bëjë perzgjedhjen në shorte paraqitet pranë komisionit dhe identifikohet nëpërmjet letërnjoftimit dhe pasi kryhet verifikimi i identitetit nga sekretariati ftohet të përzgjedhë një nga zarfat/goglat në kutinë/vazon e cila përmban të gjitha apartamentet me strukturë banimi të njëjtë.
4. Pasi subjekti përzgjedh zarfin/goglen, kryetari i komisionit hap zarfin/goglen dhe në prani të subjektit përzgjedhës dhe subjekteve të tjera përzgjedhëse lexon apartamentin e zgjedhur.
5. Rezultati i përzgjedhjes pasqyrohet në procesverbal, i cili hartohet në tre kopje, dhe firmoset nga anëtarët e komisionit dhe subjekti përfitues. Një kopje i jepet subjektit përfitues, një kopje komisionit, një kopje mbahet nga sekretariati i cili në përfundim të procesit e depoziton në protokollin e bashkisë.
6. Për rastet kur subjekti përfitues nuk paraqitet në shorte, përzgjedhja e strukturës së banimit do të bëhet si më poshtë:
- a) Kryetari i komisionit pasi sigurohet që subjekti përfitues ose përfaqësuesi i tij me prokurë nuk është paraqitur evidenton këtë fakt në procesverbalin e mbajtur nga sekretariati dhe merr një nga zarfat/goglat sipas strukture së banimit që subjekti përfiton;
  - b) Përzgjedhja nga komisioni për subjektin që nuk është paraqitur bëhet në momentin që subjekti ka të drejtë për të bërë përzgjedhjen në shorte dhe pasi mbaron kjo procedure fillohet me subjektin pasardhës në rënditje;
  - c) Rezultati i përzgjedhjes nga komisioni pasqyrohet në procesverbal në të cilin do të evidentohet fakti i mungesës së subjektit përfitues dhe që përzgjedhja është kryer nga komisioni.
7. Pasi të gjithë subjektët përfitues të pranishëm në shorte kanë kryer përzgjedhjen e tyre, sekretariati harton procesverbalin përmbledhës i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe sekretariati.

### **Neni 11**

#### **Përfundimi i procesit të shorteut publik**

1. Me përfundimin e procesit të shorteut publik, Komisioni harton raport përmbledhës në të cilin pasqyrohet zhvillimi i procesit të shorteut publik dhe rezultatet e tij.
2. Raportit i bashkëlidhen procesverbalet individuale dhe procesverbalet përmbledhëse të cilat i dërgohen Kryetarit të Bashkisë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BASHKIA LEZHË**  
**KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË SHORTIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Lezhë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2021

**PROCESVERBAL**  
**“Individual i përzgjedhjes në shorteun publik”**

I mbajtur sot me datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2021, nga Sekretariati i Komisionit të Organizimit të Shortit, për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindertuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, në prani të anëtareve të Komisionit të Organizimit të Shortit:

1. Z/Znj. Kryetar
2. Z/Znj. Anëtar
3. Z/Znj. Anëtar

Dhe subjektit përfitues Z/Znj, \_\_\_\_\_, identifikuar me letërnjoftimin nr. \_\_\_\_\_.

Subjekti \_\_\_\_\_, përzgjodhi në short dhe sipas rezultatit të përzgjedhjes subjekti përfiton banesën me strukture banimi \_\_\_\_\_, me këto të dhëna: \_\_\_\_\_.

**KOMISIONI**

Z/Znj. Kryetar  
 Z/Znj. Anëtar  
 Z/Znj. Anëtar

**SUBJEKTI PËRFITUES**

\_\_\_\_\_

**Sekretariati**

Z/Znj.

Kopje: 3(tre)





**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BASHKIA LEZHË**  
**KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË SHORTIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Lezhë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2021

**PROCESVERBAL**  
**“Përmbledhës i shorteut publik”**

I mbajtur sot me datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2021, nga Sekretariati i Komisionit të Organizimit të Shortit, për ndarjen e apartamenteve në pallatet e rindertuara për shkak të termetit të datës 26.11.2019, në prani të anëtareve të Komisionit të Organizimit të Shortit:

1. Z/Znj. Kryetar
2. Z/Znj. Anëtar
3. Z/Znj. Anëtar

Pas përfundimit të shorteut publik, ku pjesmarrësit përzgjedhen në shorte dhe në rastet kur subjekti përfitues nuk është paraqitur në shorte përzgjedhja është bërë nga Komisioni, ky i fundit hartoi procesverbalin përmbledhës së rezultatit të shorteut dhe të rezultatet janë si më poshtë:

Nr.	Emer Atësi Mbiemër i Subjektit përfitues	Subjekti që bëri përzgjedhjen	Struktura e banimit përfituese	Të dhënat e apartamentit që përfiton

**KOMISIONI**  
 Kryetar

Anëtar

Anëtar

**Sekretariati**  
 Kopje: 3(tre)